



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.128/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, përkritazi me ankesën e Njomza Eminit kandidate për deputete nga rradhet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Njomza Eminit kandidate për deputete nga rradhet e subjektit politik LDK.

### ARSYETIMI

Më datë 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga Njomza Emini kandidate për deputete nga rradhet e subjektit politik LDK me nr.rendor 48 në të cilën parashtruesja thekson se *“sipas rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me datën 30.01.2011 ka marrë gjithsej 4231 vota, ndërsa sipas raporteve të vëzhguesve të subjektit tim politik nga dita e zgjedhjeve të 12 dhjetor 2010 dhe nga dy proceset e rivotimit të datës 09 janar 2011 dhe 23 janar 2011 si dhe procesi i rinumërimit të mbi 40 % të vendotimeve sipas vendimit të KQZ-së, rezulton që unë kam shumë më shumë se kjo shifër e cila është publikuar nga KQZ-ja apo afërsisht 5900 vota”*.

Parashtruesja e ankesës më tej thekson nga gjitha këto të dhëna të cekura më lartë që te përjashtohet pjesa e vendotimeve që nuk janë rinumëruara dhe që sipas raporteve të vëzhguesve të njëjtat manipulime me votat e kandidateve janë bërë edhe në vendvotimet e parinumeruara, për këtë arsye LDK-ja ka kërkuar më parë nga KQZ-ja që të bëhet rinumërimi i tërsishëm, i të gjitha vendotimeve, kërkes kjo e refuzuar nga ana e KQZ-së. Me tej parashtruesja e ankesës pretendon se *“me votat e saj është manipuluar edhe gjatë procesit të rinumërimit në qendrën e rinumërimit, manipulime të këtilla kanë raportuar edhe vëzhguesit e LDK-së që e kanë përcjell procesin e rinumerimeve por edhe mediat (koha ditore me date 19 janar 2011)”*. Parashtruesja e ankesës me tutje thekson se *“disa prej kandidatëve nga i njejtë subjekt me të, gjatë zhvillimit të ketyre dy proceseve të votimit dhe rinumerimit i kanë shtuar votat që ka bërë që ata të renditen më lartë në listë dhe me këtë edhe të fitojnë mandatin e tyre të ardhshëm në Kuvendin e Kosovës”*. Parashtruesja e ankesës kërkon që të urdhërohet

KQZ-ja qe ta bëjë verifikimin e votave të saj dhe të kandidatëve të tjerë në listën e LDK-së qoftë përmes rinumerimit qoftë përmes ndonjë forme tjetër efektive dhe të besueshme.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për shkak se parashtresja e ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale si dëshmi, për më tepër pretendimet që paraqet ankuesja në ankesë mbështeteten vetëm në supozime e jo në fakte ose prova të cilat do ta benin të besueshme shkeljen e pretenduar. Per me teper nuk është argumentuar se në cilat qendra të votimit apo në cilat vendvotime ka ndodhur shkelja e pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 128/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi Panelit**  
**Muhamet Rexha**

